

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7007
E enjte, 28 shtator 2023
Çmimi 0.50

Thaçi nga Haga ngushëllon familjen e heroit Bunjaku



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ | FAQE 4

MASAT NDËSHKUESE MUND TA NDALOJNË SHFRENIMIN E SERBISË PËRBALLË KOSOVËS




- Veriu vazhdon të jetë 'thembra e Akilit' për shtetin e Kosovës që mbi dy dekada

Deputeti i AAK-së në Kuvendin e Kosovës, Pal Lekaj, ka kërkuar nga BE-ja të vendosë masa ndëshkuese ndaj Serbisë për shkak të sulmit terrorist të 24 shtatorit në veri. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Lekaj ka thënë

se vetëm masat ndëshkuese mund ta ndalojnë shfrenimin e Serbisë përballë shtetit të Kosovës. "Duke e njohur që ky shtet është zullumqar, në çdo moment mund të priten eskalime të situatave dhe ngjarjeve në komunat me shumicë

serbe, qoftë duke sulmuar apo edhe duke inskenuar plane për t'u viktimizuar përballë faktorit ndërkombëtar", ka thënë Lekaj, duke shtuar se do të shtohet presioni ndërkombëtar për vazhdimin e dialogut


OPOZITA PAS TAKIMIT ME OSMANIN: INTERESI NACIONAL ËSHTË MBI PARTITË



RAMA, BE-së: S'MUND TË JEMI NË NJË LINJË NËSE NUK IA KTHENI MESAZHIN SERBISË



AKTUALE



KENIA E GATSHME TA NJOHË KOSOVËN F. 7

QEVERIA E KOSOVËS NDAN 50 MIJË EURO PËR FAMILJEN E HEROIT AFRIM BUNJAKU F. 5

NJË NGA TERRORISTËT E VRARË ISHTE ROJE E SHEFIT TË BIA-S SERBE F. 5

RAMA: PUNA IME PO U PENGON DISA MINISTRAT TË KURTIT F. 6

EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI: BALLKANI PERËNDIMOR DUHET TË BASHKËPUNOJË NË SISTEMIN E PAGESAVE TIPS F. 8

SHKARKOHET BORDI I "TREPÇËS", EMËROHET NJË I PËRKOHSHËM F. 8

SPORT



LLAPI ME PËRMBYSJE FITON NDAJ MALISHEVËS F. 10

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renova@t.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Varfërimi i rezervave të Gjermanisë, Zvicra do t'i shesë tanket "Leopard II"

BERNË, 27 SHTATOR - Gjermania është "e lumtur" për vendimin neutral të Zvicrës për t'i hapur rrugë për shitjen e disa prej tankeve të saj "Leopard II" të prodhimit gjerman, për rindërtimin e rezervave të varfëruara të Berlinit nga ndihma e dhënë për Ukrainën. Në shkurt, Gjermania ka

kërkuar që Zvicra ta konsideronte shitjen e një pjese të 96 tankeve "Leopard II" që mban në ruajtje të prodhuesit "Rheinmetall AG". Për t'iu përmbajtur ligjeve zvicerane të neutralitetit, Berlinit ka siguruar Bernën se këto armë nuk do të dërgohen në Kiev por, përkundrazi, do të mbeten

në Gjermani, do t'i transferohen një aleati të NATO-s ose Bashkimit Evropian. "Ne jemi shumë të lumtur dhe mirënjohës për këtë vendim. Ne kemi nevojë për këto tanke. Ato do t'i mbushin boshllëqet tona", ka thënë Michel Fluegger, ambasador i Gjermanisë në Zvicër.



Hetuesit e OKB-së gjejnë prova në rritje për krime lufte të forcave ruse në Ukrainë

NJU-JORK, 27 SHTATOR - Një raport i ri i Komisionit të OKB-së për Hetime në Ukrainë ka paraqitur një mori provash gjithnjë në rritje për krime lufte dhe krime të mundshme kundër njerëzimit të kryera nga Rusia në luftën e saj të agresionit ndaj shtetit ukrainas. Raporti, i cili është paraqitur këtë javë përpara Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, paraqet një panoramë shkeljesh të gjera dhe abuzimesh me popullsinë civile, si dhe të shkatërrimit të qëllimshëm në masë të gjerë të infrastrukturës thelbësore. "Komisioni është i shqetësuar nga provat e vazhdueshme për krime lufte të kryera nga forcat e armatosura të Rusisë në Ukrainë. Ndërsa gjendemi në vitin e dytë të konfliktit të armatosur, populli në Ukrainë vazhdon të përballet me humbjen dhe me plagët e të dashurve të tyre, me shkatërrimin në masë të gjerë, me vuajtjen dhe traumën, si dhe me vështirësitë ekonomike që

kanë rezultuar prej kësaj. Mijëra janë vrarë dhe janë plagosur, dhe miliona vazhdojnë të jenë të zhvendosur brenda vendit apo jashtë tij", ka thënë Erik Mose, kryetar i komisionit. Rusia i ka bojkotuar punimet e këtij komisioni dhe nuk ishte e pranishme në sallë për t'iu përgjigjur këtyre akuzave. Në të kaluarën ajo ka mohuar të ketë vendosur në objektivat civilët. Shifrat e fundit nga Zyra e komisionarit të lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, flasin për 9 614 civilë të vrarë dhe 17 535 të plagosur që kur Rusia ka sulmuar Ukrainën në shkurt 2022. Agjencia ka vënë në dukje se, megjithatë, numri i viktimave mund të jetë shumë më i lartë. Statistikat e agjencisë së OKB-së për refugjatët (UNHCR) tregojnë se 5.1 milionë persona janë të zhvendosur brenda Ukrainës dhe 6 197 200 të tjerë janë larguar drejt vendeve të tjera si refugjatë. Që kur është krijuar në mars



2022, komisioni prej tre anëtarësh e ka vizituar Ukrainën mbi 10 herë, për të mbledhur informacion nga autoritetet qeveritare dhe për t'i "dëgjuar dëshmitë tronditëse" nga viktimat dhe dëshmitarët e abuzimeve. Hetuesit kanë raportuar se "sulmet me armë eksplozive në zonat e populluara kanë shkakuar shkatërrim të gjerë dhe

dëme, dhe kanë qenë shkak kryesor i vdekjeve dhe plagosjeve në radhët e popullsisë civile". Ata kanë dokumentuar sulme me armë eksplozive ndaj godinave të banimit, një stacioni hekurudhor, magazinave tregtare, objekteve mjekësore dhe të tjera, që kanë ndërprerë shërbimet dhe furnizimet jetësore. Në Kherson dhe Zaporizhia,

rajone që patën qëndruar gjatë nën pushtimin e forcave ruse, komisioni ka mbledhur prova të tjera që tregojnë se përdorimi i torturës nga forcat e armatosura ruse në zonat nën kontrollin e tyre ka qenë i përhapur dhe sistematik, duke vënë në dukje se objektivat kryesore të torturës ishin personat e akuzuar si informatorë të forcave të armatosura të Ukrainës. Prokurori i përgjithshëm ukrainas Andriy Kostin, duke iu drejtuar punimeve me një lidhje me video, ka kritikuar "mizoritë masive të kryera në një shkallë tronditëse nga Rusia gjatë luftës së saj të agresionit kundër Ukrainës". Ai ka folur me pasion dhe zemërim për dëmin e shkakuar ndaj më shumë se 19 000 fëmijëve ukrainas që janë transferuar dhe dëbuar me forcë nga vendi i tyre nga zyrtarët më të lartë të Rusisë.

Shevchenko bëhet këshilltar i Zelenskyt



KIEV, 27 SHTATOR - Ish-ylli ukrainas i futbollit, Andriy Shevchenko, është bërë këshilltar i jashtëm i presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky, raportojnë mediet ukrainase. Presidenti Zelensky ka shpallur dekretin për emërimin e Shevchenkos si këshilltar i jashtëm më 26 shtator, por nuk dihet se cilat do të jenë detyrat e tij nga përmbledhja e dekretit të presidentit. Shevchenko ka fituar një njohje

të madhe ndërkombëtare si lojtar i Milanit dhe pastaj edhe i Chelseas. Me Milanin ai ka fituar Ligën e Kampionëve në vitin 2003 dhe një vit më vonë ka marrë "Topin e Artë", çmimin më prestigjioz të futbollit. Ish-futbollisti i njohur ka luajtur 111 herë për kombëtaren ukrainase dhe ka shënuar 48 gola dhe para se të dilte jashtë vendit luajti me Dinamo Kievin. Pas karrierës së tij si lojtar, të cilën e ka përfunduar në korrik 2012, Shevchenko ishte ulur fillimisht

në stolin e ekipit vendas si ndihmëstrajner, dhe në korrik të 2016 ishte bërë trajner dhe ka udhëhequr Kombëtaren deri në çerekfinalet e "Euro 2022", që është arritja më e mirë e tij deri tani. Në sezonin 2021/22 ai ka drejtuar Genoan. Ai konsiderohet një nga futbollistët më të mirë ukrainas të të gjitha kohëve. Vitin e kaluar presidenti ukrainas Zelensky e ka emëruar Shevchenko ambasador i Fondacionit për Rindërtim dhe Zhvillim të Ukrainës.

Mbi 100 të vdekur nga zjarri në një dasmë në Irak, arrestohen 9 persona

BAGDAD, 27 SHTATOR - Nëntë persona që ishin të punësuar në sallën e dasmave në Irak, ku mbi 100 njerëz persona humbën jetën pas shpërthimit të një zjarri, janë arrestuar. Sipas informacioneve, janë

lëshuar urdhërarreste edhe kundër katër punonjësve të tjerë. Autoritetet kanë thënë se arsytet e tragjedisë ishin "mungesa e masave dhe të sigurisë, materialet e ndezshme të përdorura dhe,

me sa duket, një fishekzjarr". Kryeministri i Irakut ka shpallur tri ditë zie kombëtare. Numri i viktimave mund të rritet, ndërsa deri më tani janë konfirmuar mbi 100 të vdekur dhe 150 të plagosur.



NGJARJET NË VERI TË KOSOVËS, PRESIDENTJA VJOSA OSMANI TAKON LIDERËT E OPOZITËS

Opozita pas takimit me Osmanin: Interesi nacional është mbi partitë



Presidentja Vjosa Osmani ka takuar të mërkurën liderët e partive opozitare me të cilët ka diskutuar për zhvillimet e 24 shtatorit në veri të Kosovës. Osmani i ka siguruar liderët opozitarë se në çdo fazë të zhvillimeve do të njoftohen lidhur me zhvillimet në vend. Ndërsa lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ai i LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, e kanë përgëzuar policinë për aksionin në veri si dhe kanë ofruar mbështetjen për institucionet e vendit në përballje me Serbinë. Ata kanë thënë se interesi nacional është mbi partitë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim të ndara liderët e partive opozitare me të cilët ka biseduar për sulmin terrorist të 24 shtatorit. Në këto takime, Osmani ka qenë e shoqëruar edhe nga shefi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Petrit Ajeti. Presidenca ka njoftuar se kryetarët e partive opozitare, janë informuar, brenda kufizimeve që lejon korniza ligjore, lidhur me zhvillimet e sigurisë, punën e institucioneve të Kosovës si dhe për rreziqet e shkakutara nga Serbia për shkak të agjendës së saj destabilizuese e luftënxitëse e cila po shfaqet nëpërmjet akteve të agresionit dhe të terrorizmit. Në të gjitha takimet janë përgëzuar institucionet e sigurisë për punën e shkëlqyeshme në ballafaqim me strukturat e dirigjuara nga Serbia që kryen sulmin terrorist kundër Kosovës dhe është shprehur mirënjohje e thellë për angazhimin e pashoq dhe

sakrificën e policisë së Kosovës për të mbrojtur sovranitetin, integritetin territorial dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim. Sipas këtij njoftimi Osmani ka theksuar se uniteti nacional në këtë kohë të rëndë për Kosovën është imperativ dhe për këtë duhet të kontribuojmë të gjithë së bashku. Ajo i ka falënderuar partitë opozitare për qëndrimin korrekt dhe përkrahjen ndaj institucioneve të sigurisë në këtë fazë të ballafaqimit më agjendën destabilizuese të Serbisë kundër Kosovës.

Po ashtu, Osmani ka siguruar liderët opozitarë se në çdo fazë të zhvillimeve do të njoftohen lidhur me përgatitjet dhe punën e institucioneve si dhe do të ketë bashkërendim të plotë me aleatët tanë të cilët, në bashkëpunim me institucionet tona të sigurisë, janë garantues të paqes e stabilitetit. Osmani ka shfaqur besimin e plotë se edhe sfidat e reja që mund të shfaqen do t'i tejkalojmë të bashkuar, duke vendosur interesin e shtetit mbi të gjitha.

Pas takimit me Osmanin, liderët e

opozitës janë deklaruar për përmbytjen e bisedave që kanë pasur me shefen e shtetit.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka përgëzuar Policinë e Kosovës për profesionalizëm e treguar në aksionin e 24 shtatorit në veri si dhe ka ofruar mbështetjen e plotë në funksion të sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit. "Edhe një herë, shpreha mbështetjen dhe mirënjohjen më të thellë për të gjitha institucionet e sigurisë, posaçërisht për Policinë e Kosovës, e cila, në 24 vitet e ekzistencës së saj, nuk ka rreshtur së na bëri krenarë me profesionalizimin e dëshmuar vit pas viti në shërbim të vendit. Heroi Afrim Bunjaku është shembulli i fundit i kësaj atdhedashurie. Për mua dhe PDK-në, është krejtësisht e qartë se organizimi dhe orkestrimi i sulmit terrorist mbi Republikën e Kosovës adresën kryesore e ka në Beograd. Konfirmimi i përfshirjes së Milan Radojçiqit në këtë aksion, armatimi i sofistikuar dhe i shumtë i terroristëve, strehimi i tyre në Serbi pas sulmit dhe lartësimi i tyre si

heronj nga institucionet zyrtare të Beogradit, përfshirë shpalljen e ditës së sotme si ditë zie për ta – tregojnë për lidhjen e fortë të këtij grupi terrorist me shtetin e Serbisë", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se për PDK-në, interesi nacional është mbi të gjitha. "Si PDK, i kemi ofruar mbështetjen tonë të plotë të gjitha institucioneve të sigurisë në përballje me këtë situatë. Sot, përveç tjerash, i bëjmë thirrje edhe aleatëve tanë ndërkombëtarë që të rrisin presionin ndaj Serbisë për t'i dorëzuar tek autoritetet kosovare, terroristët të cilët Serbia i ka marrë në mbrojtje. Veprimet e tyre nuk mund të mbeten pa u ndëshkuar dhe drejtësia duhet të triumfojë", ka thënë Krasniqi.

Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka njoftuar se në këtë takim ka shprehur mirënjohjen e kësaj partie për policinë, e cila sipas tij ka fituar betejën kundër terrorizmit. Abdixhiku, ka thënë se në takim me Osmanin ka shprehur domosdoshmërinë për unitet

nacional në përballje me Serbinë. "Kam shprehur mirënjohjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës për të gjithë në shërbim. Kam shprehur po ashtu domosdoshmërinë e unitetit nacional në përballje me sfidat që mund të vijnë nga Serbia; si shtet sponsorizues e strehues i terroristëve. Djemtë e vajzat tona fituan betejën kundër terrorizmit në terren. Është koha ta fitojmë atë diplomatike në politikë. Në këtë përpjekje jemi bashkë. Në këtë përpjekje na duhen aleatë", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook". Në anën tjetër, lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, pas takimit me presidenten Osmani, ka thënë se rreziku për mundësinë e eskalimit të serishëm të situatës në veri ekziston ende. "Biseda ishte kryesisht lidhur me situatën e sigurisë në vend gjatë ditëve të fundit të ndërlidhura me sulmin terrorist që ndodhi më veri ku humbi jetën një epror i Policës së Kosovës. Kosova edhe në të kaluarën është përballur me situata të sigurisë. Kjo që ndodhi tani është e pastër terrorizëm. Është e logjikshme që të bashkëbisedohet në situata të tilla për shkak se rreziku vazhdon edhe me tutje, është prezent rreziku", ka thënë Haradinaj në një prononcim për medie, duke kërkuar që institucionet e Kosovës të koordinohen me faktorin ndërkombëtar. "Duhet që të bëjmë kujdes që edhe vendimmarrësit politik ta kryejnë me sukses punë e vete. Përballja me rreziqet e sigurisë nuk bëhet duke e bartur përgjegjësin vetëm të profesionistët, dihet ndihmesa politike edhe dihet një kurs politik i besueshëm me aleatët. Serbia nuk e fsheh faktin se është sponsorizuese, i ka stërvitur dhe i ka dhënë udhëzimet këtij grupi terrorist. Është mirë që të zhvillimet një hetim se Serbia është faktor, kjo dihet, por të vërtetohet edhe nga hetuesit ndërkombëtar me mundësi të një gjykate", ka thënë Haradinaj.

Rama, BE-së: S'mund të jemi në një linjë nëse nuk ia ktheni mesazhin Serbisë

Tiranë, 27 shtator - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka sqaruar qëndrimin e tij se përse nuk e ka përkrahur deklaratën e përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian (BE), Josep Borrell, lëshuar më 19 shtator për dialogun Kosovë - Serbi.

Ai ka thënë se kjo lidhet me zhvillimet e fundit në Kosovë, ku rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, është vrarë nga grupi terrorist, ku për "nderimin" e anëtarëve të vrarë nga ky grup Serbia ka shpallur ditë zie kombëtare.

Në një qëndrim të publikuar në "Facebook", Rama ka thënë se nuk mund të jenë në një linjë me BE-në "derisa nuk kemi një deklaratë që dënon veprimin – mesazhin që dha Serbia, kur shpalli ditë zie



kombëtare".

"Ky qëndrim lidhet me faktin se deklarata e BE-së është një deklaratë e cila jo se në vetvete ka problem, pasi që adreson gjithçka që është thënë më parë lidhur me detyrimet e Kosovës me dialogun, por ka një problem të madh, që

nuk i përgjigjet realitetit të ditëve të fundit. Dhe ne e kemi të pamundur të linjëzohemi me BE-në pa parë një deklaratë të dytë që adreson problematikën e ditëve të fundit ku ka ndodhur një zhvillim dramatik, pasi është vrarë një efektiv i PK-së nga një grup kriminal

ngaqë ka qenë qartësisht i investuar për të ushtruar terror në veriu të Kosovës, gjë që është pasuar nga shpallja e një ditë zie kombëtare në Beograd. Kjo për ne është e papranueshme, është e pajustificueshme, madje është e dënueshme, sepse është joevropiane dhe, sepse, njëkohësisht, është sinjali më i keq që Serbia mund të jepte në këtë moment për gjithë rajonin dhe për Evropën", ka thënë Rama.

Në deklaratën e datës 19, pas dështimit të dialogut, Borrelli ishte shprehur: "BE-ja u kërkon palëve të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe me mirëbesim. Kjo nënkupton fillimin e zbatimit bazuar në propozimin e BE-së pa vonesa të mëtejshme, i cili gjithashtu përfshin detyrimin e të

dyja palëve për t'i zbatuar plotësisht të gjitha marrëveshjet e dialogut të kaluar. Puna për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe duhet të fillojë pa ndonjë vonesë apo parakusht të mëtejshëm". Pas takimit më 14 shtator, nga Bashkimi Evropian kanë deklaruar se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk ishte i gatshëm të ecë përpara me dialogun, ndryshe nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili "e ka pranuar propozimin e tyre" për zbatimin e Marrëveshjes bazë për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Borrelli pas takimit të 14 shtatorit ka deklaruar se Kurti kishte këmbëngulur që fillimisht të formatizohet njohja de facto e Kosovës nga Serbia.

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

Masat ndëshkuese mund ta ndalojnë shfrenimin e Serbisë përballë Kosovës

- Veriu vazhdon të jetë "thembra e Akilit" për shtetin e Kosovës që mbi dy dekada

Deputeti i AAK-së në Kuvendin e Kosovës, Pal Lekaj, ka kërkuar nga BE-ja të vendosë masa ndëshkuese ndaj Serbisë për shkak të sulmit terrorist të 24 shtatorit në veri. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Lekaj ka thënë se vetëm masat ndëshkuese mund ta ndalojnë shfrenimin e Serbisë përballë shtetit të Kosovës. "Duke e njohur që ky shtet është zullumqar, në çdo moment mund të priten eskalime të situatave dhe ngjarjeve në komunat me shumicë serbe, qoftë duke sulmuar apo edhe duke inskenuar plane për t'u viktimizuar përballë faktorit ndërkombëtar", ka thënë Lekaj, duke shtuar se do të shtohet presioni ndërkombëtar për vazhdimin e dialogut

EPOKA E RE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Kuvendin e Kosovës, Pal Lekaj, ka thënë se zhvillimet e fundit në veri të Kosovës janë të frikshme dhe me pasojë afatgjatë.

Lekaj në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se veriu i Kosovës vazhdon të jetë "thembra e Akilit" për Kosovën tash e dy dekada. "Zhvillimet ku u shfaqën forcat militare e terroriste, duke lënë të vdekur një polic dhe tre zyrtarë të tjerë të lënduar, janë të frikshme dhe që pasojat do të jenë afatgjatë", ka thënë Lekaj.

Në këtë kontekst, Lekaj ka thënë se AAK-ja ka kërkuar hetim ndërkombëtar për këto veprime terroriste. "AAK-ja ka kërkuar hetim ndërkombëtar, sepse është mjete politik e juridik që së pari të zbardhë e faktin të vërtetën që Serbia është agresori e jo vendi ynë. Së dyti të nxjerrë para drejtësisë fajtorët. Së treti ky angazhim i ndërkombëtarëve në hetim rrjedhimisht do të ndalojë për një kohë ndonjë veprim apo ngjarje në veriu e diriguar nga Serbia, të cilat mund t'u sjellin dëme institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës", ka deklaruar Lekaj.

Më tutje, Lekaj i ka bërë thirrje bashkësisë ndërkombëtare ta ndryshojë kursin karshi Serbisë. "Serbia po vërtetohet që në asnjë mënyrë nuk po mund ta pranojë Kosovën shtet të pavarur e sovran brenda BE-së e institucioneve

ndërkombëtare, prandaj me çdo mënyrë po tenton ta destabilizojë veriu dhe t'i ndalojë proceset thelbësore për vendin. Nëse ndërkombëtarët nuk veprojnë, Serbia do të rritë intensitetin e sulmeve përmes grupeve kriminale", ka theksuar Lekaj.

Po ashtu, Lekaj ka kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare të marrë masa ndaj Serbisë për agresionin e hapur kundër Kosovës. "Vetëm masat dhe dënimet e vërteta politike mund ta ndalojnë shfrenimin e Serbisë përballë Kosovës", ka thënë ai.

Duke iu referuar zhvillimeve në veri, deputeti Lekaj ka thënë se pret që të ketë presion ndërkombëtar për vazhdimin e dialogut dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Do të ketë presion apo kërkesa të vazhdueshme për të dy vendet që dialogu të vazhdojë, por sfiduese do të jetë për ndërkombëtarët, sepse fillimisht duhet ta qetësojnë situatën dhe duhet t'i ndalojnë synimet e Serbisë që përmes grupeve kriminale ta sulmojë e menaxhojë veriu e Kosovës", ka thënë Lekaj.

"Epoka e re": Z. Lekaj, si i komentoni zhvillimet e fundit në veri të Kosovës ku një polic ka rënë në mbrojtje të sovranitetit?

Lekaj: Veriu i Kosovës vazhdon të jetë "thembra e Akilit" për shtetin e Kosovës që mbi dy dekada. Serbia cenon dhe prek gjithmonë këtë pikë të dobët të vendit tonë duke bllokuar që 24 vjet të gjitha proceset dhe të



ardhmen e qytetarëve tanë. Zhvillimet ku u shfaqën forcat militare e terroriste, duke lënë të vdekur një polic dhe tre zyrtarë të tjerë të lënduar, janë të frikshme dhe që pasojat do të jenë afatgjatë.

"Epoka e re": A duhet bashkësia ndërkombëtare të jetë më e ashpër ndaj Serbisë për agresionin e ushtruar në territor të Kosovës?

Lekaj: Bashkësia ndërkombëtare duhet ta ndryshojë kursin e veprimit përballë Serbisë. Serbia po vërtetohet që në asnjë mënyrë nuk po mund ta pranojë Kosovën shtet të pavarur e sovran brenda BE-së e institucioneve ndërkombëtare, prandaj me çdo mënyrë po tenton ta destabilizojë veriu dhe t'i ndalojë proceset thelbësore për vendin. Nëse ndërkombëtarët nuk veprojnë, Serbia do të rritë intensitetin e sulmeve përmes grupeve kriminale.

"Epoka e re": Prisni vendosjen e ndonjë mase ndëshkuese për Serbinë nga bashkësia ndërkombëtare?

Lekaj: BE-ja dhe bashkësia ndërkombëtare, përveç që i kanë dënuar sulmet e Serbisë, patjetër duhet të marrin masa ndëshkuese. Vetëm masat dhe dënimet e vërteta politike mund ta ndalojnë shfrenimin e Serbisë përballë Kosovës. Duke e njohur që ky shtet

është zullumqar, në çdo moment mund të priten eskalime të situatave dhe ngjarjeve në komunat me shumicë serbe, qoftë duke sulmuar apo edhe duke inskenuar plane për t'u viktimizuar përballë faktorit ndërkombëtar.

"Epoka e re": AAK-ja ka kërkuar hetim ndërkombëtar lidhur me këtë sulm kriminal. Jeni optimist se do të merret parasysh kjo kërkesë?

Lekaj: Po, AAK-ja ka kërkuar hetim ndërkombëtar, sepse është mjete politik e juridik që së pari të zbardhë e faktin të vërtetën që Serbia është agresori e jo vendi ynë. Së dyti t'i nxjerrë para drejtësisë fajtorët. Së treti ky angazhim i ndërkombëtarëve në hetim rrjedhimisht do të ndalojë për një kohë ndonjë veprim apo ngjarje në veriu e diriguar nga Serbia, të cilat mund t'u sjellin dëme institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës.

"Epoka e re": Çfarë ndikimi mund të kenë këto zhvillime në raport me dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë?

Lekaj: Situatat e tensionuara dhe zhvillimet e fundit i shkojnë në favor Serbisë sepse ajo fiton në kohë duke bllokuar Kosovën në dialog dhe rrjedhimisht duke e vonuar datën e liberalizimit të vizave, integrimin e

plotë të Kosovës në BE dhe organizatat ndërkombëtare si OKB-ja dhe NATO-ja. Gjithashtu, ky kaos i veriut i lejon Serbisë të krijojë plane e strategji të reja që t'i rritë kërkesat në tavolinën e dialogut. Ndikimi negativ për vendin tonë është që i bënë qytetarët e Kosovës të pasigurt e sidomos ata të komunave veriore, i bllokoi proceset jetike të vendit, rrit ikjen e qytetarëve nga vendi si shkak i frikës, si dhe e bën Kosovën vend të pasigurt për investitorët e jashtëm duke ndikuar kështu negativisht në zhvillimin ekonomik.

"Epoka e re": A pritni të rritet presioni ndërkombëtar për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel?

Lekaj: Do të ketë presion apo kërkesa të vazhdueshme për të dy vendet që dialogu të vazhdojë, por që sfiduese do të jetë për ndërkombëtarët sepse fillimisht duhet ta qetësojnë situatën dhe duhet t'i ndalojnë synimet e Serbisë që përmes grupeve kriminale të sulmojë e menaxhojë veriu e Kosovës. Fatkeqësisht, ndërkombëtarët ende nuk e njohin mirë Serbinë, pasi është ajo Serbia e Madhe që nuk është përmirësuar, është ajo e vjetra që nuk e ka harruar zanatin e terrorit, vrasjet e pushtimet. Kosova ka nevojë ta mbyllë njëherë e përgjithmonë punën me Serbinë.

Kurti: Serbët e Kosovës duhet të çlirohen nga tutela e Serbisë

Prishtinë, 27 shtator - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se sulmi i së dielës në Banjskë të Zveçanit, i ka ekspozuar vështirësitë dhe nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar në ruajtjen, mbrojtjen dhe kontrollin e kufijve të Kosovës me Serbinë.

Më 24 shtator në atë zonë Policia e Kosovës është përleshur me një grup të armatosur dhe për pasojë janë vrarë një zyrtar policor dhe tre sulmues. Tetë të dyshuar të tjerë janë arrestuar. Sipas

kryeministrit, më 24 shtator është rrezikuar siguria kombëtare e Kosovës dhe është shpërfaqur gatishmëria "e grupeve kriminale dhe terroriste, të cilat i kemi luftuar për më shumë se dy vjet e gjysmë". "Me mbi 5 milionë euro vlerë të armatimit ushtarak, dhe sasi të mjaftueshme, për një grup prej qindra luftëtarëve, është dëshmuar skenari për gjakderdhje në Kosovë", ka thënë Kurti.

Ai e ka nisur mbledhjen e qeverisë me një minutë



heshtje në nderim të zyrtarit policor të vrarë. "Kufirin me Serbinë, më shumë sesa vija e gjatë kufitare dhe terreni malor, sidomos në pjesën veriore, veçanërisht të rrezikshme dhe të vështirë e

bëjnë sjellja dhe apetiti i Beogradit zyrtar", ka thënë ai. Më tutje, Kurti ka thënë se nga provat për pjesëmarrjen e nënkryetarit të Listës Serbe, Millan Radoičiq, në këtë sulm, që Kurti e ka quajtur terrorist, është vërtetuar "rëndësia jetike e ringjalljes së pluralizmit politik të serbëve në Kosovë". "Nuk ka demokraci e liri pa pluralizëm. Serbët e Kosovës duhet të çlirohen nga tutela e Serbisë", ka thënë Kurti.

Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal

Sveçla, e ka akuzuar Radoičiqin se e ka organizuar dhe ka marrë pjesë në sulm.

Autoritetet e Kosovës e kanë konsideruar Serbinë përgjegjëse për këtë sulm, derisa presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se sulmuesit kanë qenë serbë të Kosovës të ngopur nga "terrori" i Kurtit.

Sulmet ndaj Policisë së Kosovës janë dënuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian dhe është bërë thirrje për përballjen e fajtorëve me drejtësi.

Qeveria e Kosovës ndan 50 mijë euro për familjen e heroit Afrim Bunjaku

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Qeveria e Kosovës ka ndarë 50 mijë euro për familjen e heroit Afrim Bunjaku që është vrarë nga grupi terrorist në Banjskë të Zveçanit. Në hyrje të mbledhjes, Qeveria e Kosovës e ka nderuar me një minutë heshtje rreshterin e policisë të rënë në krye të detyrës. Kurti ka thënë se Afrimi Bunjaku ka rënë në betejën e

Kosovës për ligj dhe kushtetutshmëri. "Në betejën e Kosovës për ligj dhe kushtetutshmëri aty e kishim Afrimin, ndërsa për familjen e tij sot e çdo ditë tjetër është e gjithë Kosova. Është obligim yni që e kemi përballë vetëmohimit të Afrimit ne sado pak ta përbushim me atë çka mundemi e kemi për atë që ai la mbrapa më të dashurit e tij,



bashkëshorten Lumnijën, vajzën Arbenitën dhe djemtë Jetlumin e Fatlumin. Andaj ne sot do të aprovojmë vendimin për ndarjen e 50

mijë eurove për t'i dalë në ndihmë familjes së Afrimit. Para veprës heroike të Afrimit çdoherë do të përkulemi me nder dhe atë do ta kemi gjithmonë në mendje, zemra dhe shpirtrat tanë", ka thënë Kurti.

Bunjaku është vrarë në krye të detyrës në përplasjen e armatosur kundër grupit terrorist që udhëhiqej nga Milan Radojiçiqi, nënkryetar

i Listës Serbe, i kërkuar nga Kosova për vrasjen e Oliver Ivanoviçit dhe i sanksionuar nga ShBA-ja dhe Britania e Madhe. Po ashtu, rreshteri Bunjaku është nderuar me urdhrin "Hero i Kosovës" nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani. Vrasja e Bunjakut dhe sulmi terrorist në veri janë dënues nga të gjithë, duke përfshirë edhe faktorin ndërkombëtar.

Thaçi nga Haga ngushëllon familjen e heroit Bunjaku

HAGË, 27 SHTATOR - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ngushëlluar përmes telefonit familjen e policit të vrarë në veri, Afrim Bunjaku. Lajmin e ka bërë me dije nënkryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku. Ai ka shkruar në "Facebook" se Thaçi ka shprehur mirënjohje për sakrificën e lartë të policit Bunjaku në shërbim të atdheut. "Me miq, bashkëpunëtorë e bashkëlufëtare, vizitua familjen e heroit Afrim Bunjaku, për të shprehur

ngushëllimet më të thella për sakrificën e heroit më të ri të Republikës, i cili ra heroikisht në mbrojtje të sovranitetit të shtetit të Kosovës. Nga Haga, përmes telefonit, familjarët e Afrimit i ngushëlloi edhe presidenti Hashim Thaçi, i cili është prekur thellësisht nga rënia e tij, duke shprehur mirënjohje për sakrificën e lartë të tij në shërbim të atdheut. Ngushëllimet më të thella familjes Bunjaku, miqve dhe dashamirëve! Lavdi veprës së heroit Afrim Bunjaku!", ka shkruar Lushtaku.




Një nga terroristët e vrarë ishte roje e shefit të BIA-s serbe

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se një nga terroristët që është eliminuar nga Policia e Kosovës ishte roje e shefit të BIA-s, Aleksandër Vulin. "Dje përmes videopamjeve dëshmuam prezencën e kryekriminalit dhe udhëheqësin e aksionit terrorist Milan Radojiçiq. Ndërkaq, sot është konfirmuar që njëri nga të vrarët që ishte po ashtu pjesëmarrës i atij akti është

edhe Bojan Mijailović, turpëroja e shefit të BIA-s serbe, Aleksandër Vulin, në vizitën e tij në Republikën e Kosovës në vitin 2013", ka shkruar Sveçla në "Facebook". Ai ka thënë se shteti i Serbisë është këmbë e krye i përfshirë në këtë sulm terrorist me qëllim destabilizimin e Republikës së Kosovës. "Për këtë gjë tashmë ekziston edhe lidhja formale e strukturore e përfshirjes së Aleksandër Vuçiq në sulmin e 24

shtatorit në Banjskë të Zveçanit: Milan Radojiçiq, si nënkryetar i Listës serbe dhe turpëroja e Aleksandër Vulinit, shef i BIA-s. Të dy këta po ashtu të sanksionuar në listën e zezë të ShBA-së. Të dy këta nga njerëzit më të afërt të presidentit të Serbisë", ka shkruar Sveçla. Po ashtu, Sveçla ka publikuar një dokument si dëshmi se Serbia ka mbështetur politikisht, financiarisht dhe logjistikisht grupin terrorist serb, i cili e ka sulmuar



policinë më 24 shtator. Ai ka thënë se ky dokument është vërtetim të cilin ushtria e

Serbisë ua ka dhënë atyre me rastin e dorëzimit të lansuesit të granatave.

Zyrtari i OSh-së: Njerëzit në Kosovë po vdesin nga sëmundje lehtë të parandalueshme

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Të mërkurën në Prishtinë ka filluar punimet simpoziumi ndërkombëtar për sëmundjet jontjellëse. Në hapje të këtij simpoziumi është potencuar se sëmundjet jontjellëse janë në thelb "armik i padukshëm" që shkaktojnë vdekje në gjithë botën. Oleksandr Martynenko, udhëheqës i zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OSh) në Prishtinë, ka thënë se në Kosovë njerëzit janë duke vdekur nga sëmundjet lehtë të parandalueshme. "Njerëzit në Kosovë po vdesin nga sëmundje lehtë të parandalueshme. Mënyra më e mirë për t'i parandaluar sëmundjet jontjellëse është mjeku



familjar, kujdesi parësor shëndetësor", ka thënë Martynenko.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka thënë se këto sëmundje janë vështirë të

menaxhuara prandaj, sipas tij, ndërveprimi institucional është i rëndësishëm. Në këtë aspekt, Vitia ka thënë se aktorët shëndetësorë janë duke bërë maksimumin për t'i adresuar sëmundjet kronike jontjellëse. "Po punojmë për ngritjen e buxhetit në 300 milionë në trajtimin e këtyre sëmundjeve. Një nga aspektet më të rëndësishme në trajtimin e këtyre sëmundjeve është edukimi në kujdesin e tyre shëndetësor. Prandaj është e rëndësishme të ketë edhe përkrahje emocionale dhe shoqërore për të prekurit nga këto sëmundje. Simpoziumi ka rëndësi të veçantë në avancimin e profesionistëve tanë dhe rritjen e politikave shëndetësore, sepse ato

duhet të diskutohen dhe rishikohen vazhdimisht. Duke u dëshiruar sukses në këtë simpozium të gjithëve dhe mysafirëve ndërkombëtarë, natyrisht se është e mundur të jetojmë një jetë të mirë e të shëndetshme pavarësisht prej problemeve që i shkaktojnë ato. Nuk kam dyshim se me koordinim do të mund t'ia arrijmë këtij qëllimi", ka thënë Vitia. Në anën tjetër, drejtori i Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK), Naser Sahiti, ka thënë se këto sëmundje ndryshe quhen edhe sëmundje të heshtura për shkak të tendencës së tyre për t'u zhvilluar ngadalë.

Rama: Puna ime po u pengon disa ministrave të Kurtit

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, i është kundërpërgjigjur ministrit të Financave, Hekuran Murati, lidhur me projektin "Solar4Kosovo", për të cilën Murati e ka akuzuar Ramën se po i merr meritat për punën e të tjerëve. Rama ka thënë se tash e sa kohë puna e tij është duke u penguar nga disa ministra të qeverisë Kurti, duke aluduar në Muratin dhe ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çekun. "Një prej këtyre sulmeve ndodhi edhe dje, kur kryeqyteti nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me komunën e Obiliqit për realizimin e projektit të ngrohjes diellore 'Solar4Kosovo'. Me anë të kësaj marrëveshjeje ne si

kryeqytet kemi marrë përgjegjësinë që t'i kryejmë obligimet financiare që do të dalin nga procesi i shpronësimit të pronave të cekura në marrëveshje, sepse pa këtë shpronësim nga ana e kryeqytetit nuk bëhet projekti", ka shkruar Rama në "Facebook". Rama ka thënë se për këtë marrëveshje Prishtina dhe Obiliqi kanë punuar 18 muaj në mënyrë intensive dhe për këtë proces kanë bashkëpunuar me Ministrinë e Mjedisit për ta rregulluar jetën e qytetarëve. Ai ka thënë se njëjtë ka ndodhur edhe për Lojërat Mesdhetare, duke shtuar se kjo gjuhë e përdorur nga ministra të caktuar të qeverisë, përveçse e dëmton organizimin e këtyre lojërave, e prish

edhe imazhin e Kosovës. Rama ka deklaruar se këta ministra i kanë mbajtur rreth 30 milionë euro të kryeqytetit të bllokuara, duke përfshirë edhe projektin e unazës së kryeqytetit. "Më tutje, këta ministra: i mbajtën afër 30 milionë euro buxhet të kryeqytetit në mënyrë të padrejtë deri në muajin korrik 2023 nuk e përfshinë kryeqytetin në përzgjedhje të projekteve të mëdha infrastrukturore siç është salla e Operës dhe Baletit vazhdojnë ta bllokojnë projektin e unazës së kryeqytetit dhe vazhdimisht refuzojnë kërkesat për bashkëpunim. Prandaj, si kryetar i kryeqytetit do ta vazhdojë punën me përkushtim për transformimin e kryeqytetit në frymë



bashkëpunuese dhe u bëj thirrje ministrave përkatës ta ndryshojnë qasjen në raport me Prishtinën dhe

të angazhohen për të mirën e të gjithë qytetarëve pa dallim", ka thënë Rama.

Luftimi i korrupsionit mbetet sfidë për institucionet, kërkohet bashkëpunim më i madh

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Organizata Joqeveritare (OJQ) "Aktiv" ka mbajtur të mërkurën konferencë për transparencën e administratës lokale në kuadër të projektit "Forcimi i transparencës dhe sundimit të ligjit në komunat serbe në Kosovë". Tamra Geig nga Byroja për çështje ndërkombëtare të narkotikëve dhe zbatimit të ligjit ka thënë se ShBA-ja do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën. Madje Geig ka thënë prioritetin e ShBA-së mbetet bashkëpunimi për një Kosovë më të sigurt. "Siç e dini ShBA-ja ka qenë partnere e Kosovës për më shumë se dy dekada dhe ne do ta vazhdojmë mbështetjen tonë. Ne po përpiqemi t'i ngrehim kapacitetet e shoqërisë civile në Kosovë. Ne e dimë që kjo do t'i forcojë



institucionet e Kosovës dhe për këtë është shumë e rëndësishme kjo konferencë. Ne jemi të gjithë së bashku që të sigurohemi që komunitetet do të bashkëpunojnë për një Kosovë më të sigurt. Ky

është prioritet edhe për ShBA-në", ka thënë Geig. Ndërsa Miodrag Miliceviq, drejtor ekzekutiv i OJQ "Aktiv", ka bërë me dije se kanë hartuar një program për digjitalizimin e raportimit

kundër korrupsionit. Ndërsa drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, ka thënë se prioritet kryesor i tyre mbetet trajtimi i barabartë i të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me korrupsionin. "Prioriteti ynë është të kemi një trajtim të barabartë në të gjitha lokalitetet e Kosovës. Këtu kemi pasur sfida, por jemi munduar që gjithmonë të ofrojmë bashkëpunim edhe me komunitetet joshumicë. Secili mandat i qeverisjes duhet të jetë i ndërlidhur me shoqërinë civile, për transparencë të plotë", ka thënë Buleshkaj. Më tutje, drejtori ekzekutiv në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka thënë se duhet punë më intensive për luftimin e korrupsionit. Ai ka

kërkuar më shumë përfshirje të qytetarëve në nivelin lokal dhe qendror. "Si komunat si niveli qendror duhet të ketë më shumë bashkëpunim me qytetarët dhe me institucionet. Prokurorët krejt punën e tyre e bazojnë në letra. Sot ka mundësi të llojllojshme se si duhet luftuar korrupsionin. Hetimet dhe përgjimet nuk ekzistojnë fare", ka thënë Miftaraj. Kurse Ismet Kryeziu, drejtor i Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), ka thënë se Kosova ka ende sfida në luftimin e korrupsionit. "Kosova edhe pse ka pasur një sukses, dhe ka bërë një hap tutje, megjithatë ka sfida në miratimin e politikave të ligjeve dhe në zbatimin e këtyre ligjeve që garantojnë transparencë", ka thënë Kryeziu.

Arrestohen dy të dyshuar në Gjakovë, u kapën me drogë

GJAKOVË, 27 SHTATOR - Zyrtarët policorë në Gjakovë kanë ndaluar personin me inicialet S. K., të cilit i është gjetur një sasi

e substancës narkotike e që dyshohet të jeta marijuanë. Më pas, policia e ka kontrolluar banesën e tij, ku jetonte edhe S. L. Aty janë

gjetur lëndë narkotike, fara kanabisi, peshore, pesë telefona dhe një thikë. Pesha e përgjithshme e lëndës narkotike që

dyshohet të jetë marijuanë është 30.88 gr dhe 1.04 gr fara të kanabisit. Të dyshuarit janë ndaluar për 48 orë.



Kenia e gatshme ta njohë Kosovën

NAIROBI, 27 SHTATOR - Kenia ka shprehur gatishmërinë e saj për ta njohur pavarësinë e Kosovës. Ministri i Jashtëm i Kenisë, Alfred Mutua, ka konfirmuar se po zhvillohen diskutime që shteti i tij ta njohë plotësisht pavarësinë e Kosovës. Njohja nga Kenia pritet të

finalizohet me vizitën e ardhshme të presidentes Vjosa Osmani atje. Lëvizja e Kenias drejt njohjes së Kosovës ka marrë vrull në fillim të këtij viti kur ka njohur zyrtarisht pasaportat e Kosovës. Ndërsa ky zhvillim nuk është publikuar gjerësisht në atë

kohë, ai shënoi një hap të rëndësishëm në formalizimin e lidhjeve diplomatike midis dy vendeve. Ky njoftim vjen pas takimit të presidentit kenian William Ruto me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork.



Kamberi, Vuçiqit: Hiqni dorë nga ëndrra për Kosovën



PRESHEVË, 27 SHTATOR - Deputeti i vetëm shqiptar në Parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka kërkuar edhe një herë nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të heqë dorë nga ëndrrat e tij për kolonizimin e Kosovës. Ai ia ka rikujtuar presidentit serb sintagmën e tij kur ishte bashkëpunëtor i Sllobodan Millosheviqit: "T'i vrasim 100 për 1". Kamberi që është edhe kryetar i partisë më të madhe shqiptare në Luginën e Preshevës - Partisë për Veprim Demokratik, ka rikujtuar edhe deklaratën e presidentit serb: "Mund të na vrisni të gjithëve, por Kosovën nuk e njohim".

Kamberi ka thënë se këto deklarata janë armiqësore sepse askush nuk dëshiron t'i vrasë serbët. "Mjaft me patetizmin tuaj, z. president. Mos e frikësoni dhe armiqësoni popullin më kot sepse askush nuk dëshiron t'ju vrasë. Shqiptarët janë për paqe sepse pikërisht ata kanë qenë viktimat më të mëdha të ambicieve kolonialiste të fqinjëve të tyre në shekullin e kaluar. Por ju është koha e fundit të kthjelloheni nga andrallat tuaja kolonialiste rreth Kosovës", ka shkruar Kamberi në "Facebook". Ambiciet e presidentit serb, sipas Kamberit, janë "njësoj sikurse reklamimi i çmimit të salomit (parizerit)". "Ato tashmë po

shkaktojnë humbje në jetë njerëzish. Brengosja juaj për serbët e Kosovës është destruktive. Fundja, 'do të vrasim 100 për 1' kurrë nuk e ka thënë apo përsëritur një shqiptar. Autorësia e saj ju përket juve", ka shkruar Kamberi, duke iu referuar presidentit serb. Gjatë viteve '90 president serb, që atëbotë ishte në strukturat e larta të Partisë Radikale Serbe, kishte thënë në Parlamentin e Serbisë se nëse boshnjakët e vrasin një serb, serbët do t'i vrasin 100 boshnjakë. Kujtojmë se vetëm në Srebrenicë kishte ndodhur gjenocidi më i madh ndaj popullsisë civile ku ishin vrarë më shumë se 8 mijë civilë bonjakë nga ushtria serbe.

Hapet rruga për në Banjskë

ZVEÇAN, 27 SHTATOR - Rruga që të çon në fshatin Banjskë të Zveçanit është hapur në mesditën e së mërkurës. Më 24 shtator në këtë fshat Policia e Kosovës është përlëshur me një grup të armatosur dhe për pasojë ka mbetur i vrarë zyrtari policor Afrim Bunjaku dhe tre sulmues. Rruga ka qenë e mbyllur prej asaj dite. Policia e Kosovës ka përfunduar bastisjet nëpër shtëpitë dhe objektet në dhe përreth fshatit Banjskë të Zveçanit në pasditen e së martës. Grupi, që fillimisht ka sulmuar policinë e cila po tentonte ta largonte një bllokadë nga rruga, ishte strehuar në manastirin e Banjskës, nga i cili i ka vazhduar sulmet ndaj policisë. Më 25 shtator Policia e Kosovës ka ekspozuar armët dhe pajisjet e tjera që ka thënë se i ka gjetur në Banjskë. Po ashtu, më 26 shtator autoritetet e rendit kanë bërë me dije se në Banjskë kishin



konfiskuar edhe më shumë armatime të lojeve të ndryshme. Gjatë ekspozimit të armëve në Mitrovicë të Jugut më 25 shtator,

drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka thënë se në dhe përreth manastirit në Banjskë janë gjetur armatime të kalibrave të

ndryshëm, raketahedhës, eksplozivë, detonatorë, emblema të ndryshme, dronë, letra ngjitëse me shenjën e KFOR-it, uniforma -

disa prej të cilave me emblema të ushtrisë italiane - tabela veturash me akronime të qyteteve të ndryshme të Serbisë, granatahedhës dore (zolla), shumica e të cilave janë të prodhuara në vitin 2021. Hoxha dhe ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, e kanë akuzuar nënkryetarin e Listës Serbe, Millan Radoiçiq, se ka udhëhequr grupin prej 30 personash që sulmuan policinë. Për më tepër, këta zyrtarë kanë thënë se Radoiçiq ka marrë pjesë personalisht në sulm. Këto akuza më 26 shtator Sveçla i ka mbështetur në një video të incizuar me dron që dëshmon se Radoiçiqi ishte i pranishëm në Banjskë. Lidhur me sulmin në veri, autoritetet në Kosovë kanë arrestuar tetë persona dhe ndaj tre prej tyre kanë shqiptuar masën e paraburgimit prej një muaji.

Stano për masat e mundshme ndaj Serbisë pas sulmit terrorist: BE-ja do t'i presë hetimet para se të marrë një vendim

BRUKSEL, 27 SHTATOR - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, ka bërë me dije se BE-ja do ta presë përfundimin e hetimeve të plota për sulmin terrorist të së dielës në fshatin Banjskë në veri të Kosovës, para se të marrë një vendim dhe konkluzione për çfarëdo mase dhe pasojë,

duke mos dashur të komentojë pretendimet se disa shtete anëtare kanë kërkuar vendosjen e masave ndaj Serbisë. "Nuk është kompetenca ime të jap informacione nga bisedat konfidenciale dhe informacion për mbledhjen e Komisionit për Politikë dhe Siguri të martën", ka thënë

Stano. Ai ka theksuar se BE-ja ka thënë edhe më herët se masat e vendosura ndaj Prishtinës mund të zbatohen edhe për Serbinë, dhe kur shtetet anëtare të BE-së të marrin një vendim formal për to, kur dhe cilat masa, për çfarë arsye, do të shpallen publikisht.



Ndahen 6 milionë euro për rrugën Prishtinë - Podujevë

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Qeveria e Kosovës ka ndarë të mërkurën edhe 6 milionë euro për ndërtimin e rrugës Prishtinë - Podujevë. Vendimi është marrë me kërkesë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që drejtohet nga Liburn Aliu.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se rruga ka qenë nevojë e kamotshme e trevës së Llapit për t'u lidhur me kryeqytetin sa më shpejt. Ndërsa ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se parashikimi është që deri në fund të vitit nevojitet kjo shumë e parave. "Kemi parë

dinamikë të shtuar në Ministrinë e Mjedisit dhe parashikimi është që deri në fund të vitit nevojiten edhe 6 milionë euro të tjera. Si rezultat propozojmë që këto mjete të ndahen dhe të merren nga kontigjencat për shpenzime kapitale", ka thënë Murati.



Qeveria ndan mbi 1.1 milion euro për dëmet nga vërshimet



PRISHTINË, 27 SHTATOR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë 1 milion e 123 mijë e 675 euro për dëmet e shkaktuara nga vërshimet. Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, të mërkurën në mbledhjen e qeverisë ka bërë me dije se përfituese do të

jenë 14 komuna. "Ministria e Bujqësisë propozon për miratim vendimin për mbështetje financiare për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore gjatë vitit 2022 për komunat Deçan, Gjakovë,

Graçanicë, Junik, Kamenicë, Malishevë, Prishtinë, Vushtrri, Gjilan, Lipjan, Novobërdë, Skenderaj, Rahovec dhe Podujevë. Është e rëndësishme të potencohet se ky vendim nuk bie në kundërshtim me vendimin e

qeverisë të datës 29.09.2022 në të cilin parashihet kompensimi i dëmeve për të gjitha kategoritë që kompensimi të jetë nga sekretariati i Ministrisë së Punëve të Brendshme, mirëpo një vendim i tillë ka ardhur pasi disa nga

komunat e lartcekura nuk i janë përmbajtur udhëzuesit të hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe se ky proces ose kjo pikë e rendit të ditës është vetëm evitim i lëshuar nga komunat në fjalë", ka deklaruar Peci.

Guvernatori Ismaili: Ballkani Perëndimor duhet të bashkëpunojë në sistemin e pagesave TIPS



TIRANË, 27 SHTATOR - Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të bashkëpunojnë në sistemin e pagesave të shpejta të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), i njohur si TIPS. Kështu ka thënë guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, gjatë forumit të ministrave të Ekonomisë në kuadër të Procesit të Berlinit në Tiranë. Në këtë forum Ismaili ka shpalosur orientimin strategjik të BQK-së drejt reformimit të

Sistemit Kombëtar të Pagesave (TIPS), si dhe rëndësinë e ndërlidhjes me sistemet e pagesave regjionale dhe të Bashkimit Evropian. "Përveç kontributit në ekonomi, për Kosovën ky proces ndikon edhe në shfrytëzimin e përfitimeve të gjëra nga bizneset, qytetarët dhe diaspora, në kuptimin e uljes së koston, si dhe rritjes së shpejtësisë dhe sigurisë së transaksioneve të pagesave dhe remitencave", ka thënë Ismaili.

Shkarkohet bordi i "Trepçës", emërohet një i përkohshëm

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Qeveria e Kosovës ka shkarkuar Bordin mbikëqyrës dhe ka emëruar një të përkohshëm në ndërmarrjen "Trepça".

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se shkarkimi i bordit vjen si pasojë e dorëheqjes së dy anëtarëve të bordit dhe

moszbatimin e punëve sipas ligjit. Mandati i bordit të përkohshëm nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj, ka thënë ministrja Rizvanolli. Të

emëruarit e bordit të përkohshëm janë: Rrezarta Pllana, kryesuese dhe anëtarë Alban Krasniqi, Merita Beqiri-Gashi e Dragisha Kërstiq.



'Kulla e Ngujimit' dhe historia e izolimeve



Kulla e Ngujimit, monument kulture i Kategorisë së Parë në Shqipëri, është një nga monumentet e rralla të historisë arkitekturore të Veriut. Ndërtimi unik njihet në Dukagjin si vendi ku qëndronin ata që kishin kryer një akt në kundërshtim me ligjet e kanunit dhe prisnin derisa të arrihej pajtimi.

Kulla e Ngujimit gjendet në Theth dhe njihet si një nga atraksionet turistike kryesore të këtij fshati të njohur alpin. Kulla ka strukturë katërfaqëshe me çati tipike alpine. Ekzistenca e saj përmendet nga Franc Nopça, një nga studiuesit më të njohur hungarezë, i cili ka udhëtuar në viset malore të Shqipërisë në fillim të shekullit XX. Mënyra e ndërtimit mbi shkëmb, dhe izolimi me gurë i kullës, është karakteristike për trevat e thella të veriut. Këto fortesa dominojnë ndërtimet e tjera shqiptare në aspektin e vetëmbrojtjes. Dritaret e vogla si frëngji u jepnin përparësi

banorëve të kullës të ndiheshin të sigurt dhe të mos diktoheshin nga armiqtë jashtë fortesës.

Kulla e Thethit e ka kryer edhe funksionin e nguimit, pasi aty izolohehin ata që kryenin një akt të rëndë, por edhe funksionin e pajtimit. Në kohën që i ngujuari qëndronte i izoluar në kullë, pleqtë e fshatit nisnin bisedimet mes familjeve që ishin prekur nga konflikti. Fortesat e tilla nuk mund të ruheshin nga armiku pa armët e zjarrit.

Periudha kur këto tipologji kullash e humbën kuptimin e ndërtimit të tyre ishte ajo e viteve 1945-'90, ku shumë prej tyre u kthyen në magazina bujqësore, vatra kulture, apo dhe u shembën nga harresa.

Kanuni i Lekë Dukagjinit ka nisur të zbatohet në Malësinë e Veriut të Shqipërisë disa shekuj më parë. I transmetuar me anë të fjalëve të urta, të formuluar si të thëna prej princit Lekë Dukagjini dhe të

transmetuara gojë më gojë, ai mbijetoi i pashkruar dhe u zbatua si një "ligj" në ato zona deri në kapërcyell të shekujve XIX-XX, kur prifti Shtjefën Gjeçovi vendosi ta hedh në letër.

Për pasardhësit e banorëve të këtyre zonave, Kanuni nuk mund të lexohej, por vetëm të përcillej nga ati tek biri me të thënë. Në këtë kullë, pajtimi i fundit i gjakut është bërë më shumë se një shekull më parë, nëse do t'i referohemi kujtimeve të udhëtares britanike Edit Durham, që shkeli në këtë zonë në vitet e para të shekullit XX. Pyetjes së saj se kur ka qenë pajtimi i fundit i gjakut, banorët e Thethit i thanë "10 vite më parë" dhe prej asaj kohe ndërtesa nuk ka parë më brenda saj as nguim të fajësit dhe as pleqtë e moçëm që mblihdeshin për të pajtuar familjen e gjaksit me atë të viktimit.

Shkrimtarja dhe artistja angleze nuk e ka menduar se pikërisht

vizatimi i bërë prej saj në librin Shqipëria e epërme, e ka kthyer këtë kullë në një atraksion ekzotik për mijëra turistë të huaj dhe vendas që këto 10 vitet e fundit kanë vërshuar në këtë fshat, duke rizbuluar atë magji që ajo e pa me sy më shumë se një shekull më parë. Pse Kulla e Ngujimit është në fakt "Kulla e Pajtimit".

Gojdhënat e ruajtura si fakte historike nga banorët flasin për pajtimin e më shumë se 300 konflikteve nga e gjithë zona e Shalës, pikërisht në këtë vend. E ndërtuar katër shekuj më parë si kullë mbrojtjeje nga armiku, ajo ka ndryshuar disa herë funksion si kullë nguimi e pajtimi, si kasolle e lënë në harresë gjatë komunizmit dhe sot si objekt turistik.



Po çfarë ndodhte brenda këtyre mureve nga koha e Lekë Dukagjinit deri në fund të shekullit XIX?!

Në vend të themeleve ajo qëndron mbi një gur të madh, duke i

mbijetuar shekujve dhe të gjitha fenomeneve natyrore, por sot mbi fatin e saj flitet shumë. E ngjashmja e saj në Curraj të Epërm në Tropojë u shemb e lënë në harresë vetëm disa vite më parë dhe kjo e bën kullën e Thethit edhe më unike e të rëndësishme për trashëgiminë kulturore të Shqipërisë. I vetmi rikonstrukcion që i është bërë është çatia e re e financuar nga Ambasada holandeze.

Në kohën e komunizmit, kulla u deklarua si kasolle, të vetmen pronë që kishin për t'i shpëtuar ndonjë vale shembjeje, por dhe në atë kohë njerëzit që ia dinin historinë vinin fshehurazi e bënin foto para saj.

Duke besuar se kjo është koha e dytë e lavdishme e jetës së Kullës, trashëgimtarët e saj po bëjnë përpjekje për ta vendosur atë nën mbrojtjen e UNESCO-s, duke e lënë si testament të trashëgimisë botërore.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Llapi me përmbysje fiton ndaj Malishevës

Llapi ka regjistruar një fitore të madhe në përballje me Malishevën, pasi disavantazhin nga 0-2 e ka rikthyer në 3-2. Nga tri pikë i kanë rrëmbyer edhe Ballkani dhe Gjilani, derisa sot (e enjte) zhvillohen edhe dy ndeshjet tjera ku përballen Prishtina-Dukagjini dhe Feronikeli '74-Drita

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Skuadra e Llapit ka bërë rikthim sensacional në ndeshjen ndaj Malishevës, të cilën e fitoi me rezultat 2-3. Vendasit avancuan me dy gola epërsi, por ishin mysafirët që nuk u dorëzuan dhe fitoren e siguruar në minutat shtesë. Malisheva shënoi pas njëzet minutave lojë nëpërmjet Oshafit dhe me këtë rezultat përfundoi pjesa e parë e ndeshjes. Në fillim të pjesës së

dytë, Brruti realizoi për 2-0. Hyseni e ngushtoi epërsinë e vendasve në 2-1, në minutën e 58-të. Në minutën e fundit të kohës së rregullt, Januzi realizoi për rezultatin 2-2, derisa në minutën e nëntë shtesë Hyseni realizoi për rezultatin 2-3. Më tri pikët e reja, Llapi e ruan pozitën e parë në tabelë me 16 pikë, kurse mbetet në kuotën e 9 pikëve. Fitore kanë regjistruar edhe Ballkani dhe Gjilani në përballje me Fushë Kosovën, përkatësisht Lirinë. Kampionët e Ballkanit e

mposhtën Fushë Kosovën me rezultat 2-0, derisa golat i realizuan Bleart Tolajt dhe kapiteni Edvin Kuç. Ballkani ka 16 pikë sa edhe skuadra e Llapit që është lidere, kurse Fushë Kosova ka vetëm një pikë të grumbulluar nga shtatë ndeshjet e zhvilluara. Fitore ka shënuar edhe skuadra e Gjilanit në përballje me Lirinë (1-0). Golin e vetëm në këtë ndeshje e shënoi Basha në minutën e 55-të, nga penalltia. Pas tri pikëve të reja Gjilani ngritet në kuotën e shtatë pikëve, derisa prizrenasit kanë një



pikë me pakë të grumbulluar. Ndërsa sot (e enjte) zhvillohen edhe dy ndeshjet tjera të javës së

shtatë ku takohen Prishtina-Dukagjini dhe Feronikeli '74-Drita.

Çeku: Stadiumi nacional do të jetë pasuri për të gjithë, s'duhet të shndërrohet në betejë lokale dhe zonale

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Stadiumi nacional ishte bërë temë diskutimi që prej nisjes së përmendjes së tij. Ndryshimi i lokacionit, herë në Drenas e herë në Bërnice, ishte bërë qesharak dhe një betejë lokale. Sidoqoftë, ministri i Sportit, Hajrulla Çeku, thotë se lokacioni nuk duhet të bëhet aq kryefjalë, kur bëhet fjalë për një projekt aq gjigant dhe për një pasuri që do ta shijojnë të



gjithë në vendin tonë. "Është me rëndësi të sqarohet se stadiumi nacional do të ndërtohet. E kemi

marrë obligim në aplikimin e kontratën tonë me Komitetin Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare për organizimin e këtyre Lojërave në vitin 2030. Do të ndërtohet në territor të Kosovës. Do të përdoret nga sportistët dhe sportdashësit e Kosovës. S'besoj se një projekt kaq i rëndësishëm duhet të shndërrohet në betejë lokale e të zonave të ndryshme, pasi do të jetë pasuri për të gjithë",

u shpreh ministri i Sportit në konferencë për shtyp pas mbledhjes së qeverisë. Stadiumi nacional është pjesë e zotimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës pasi vendi ynë e fitoi të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare në vitin 2030. Një stadium modern pritet të ndërtohet në afërsi të Prishtinës, më saktësisht në Bërnice. Gjithashtu, ministri Çeku ka

zbuluar se ka nënshkruar memorandume me 16 kryetarë të komunave të Kosovës dhe me Federatën e Futbollit të Kosovës. Ndër të tjera, ai premtoi se do të ndërtohen 27 stadione të kategorive të ndryshme dhe fusha përcjellëse. Sa i përket infrastrukturës së futbollit, planifikohet që gjithçka të përfundojë dhe të kompletohet në vitin 2028, pra pesë vjet nga tash.

Etna Rexhepi: Ndjenjë e veçantë ta përfaqësosh shtetin tënd

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Një nga basketbollistët më të talentuar dhe me të ardhme të ndritur është Etna Rexhepi. Ajo së fundi ishte pjesë e Kampit Basketball Without Borders në Wrocław të Polonisë. Ky kamp elitari ishte për zhvillimin e shkathtësive individuale të lojtarëve të talentuar të regionit. Basketbollistja e grupmohave të reja është pritur në Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) nga drejtori teknik Arben Krasniqi dhe nga menaxheri i Përfaqësuesëve të Kosovës, Adriatik Rraci. Krasniqi dhe Rraci i kanë ofruar përkrahje, duke konfirmuar

mbështetjen nga FBK-ja për të dhe zhvillimin e saj. Gjatë takimit kanë biseduar për përvojën e saj në Kamp dhe ecurinë për të ardhmen. "Basketball Without Borders Europe 2023 ka qenë shumë i rëndësishëm për mua dhe të ardhmen time. Dua ta falënderoj FBK-në për pjesëmarrjen në këtë kamp. Shpresoj se do të më ndihmoj shumë. Ka qenë një përvojë shumë e mirë për mua dhe FBK më ka qëndruar pranë", është shprehur Rexhepi për faqen zyrtare të FBK-së. Ajo fitoi çmimin Sportsmanship Award në këtë kamp. "Ky çmim



ishte shumë i rëndësishëm për mua dhe ishte në përgjithësi. Do të thotë për angazhimin e treguar, sjelljen, gjithçka", shtoi 16-

vjeçarja. Kjo ishte hera e parë që një basketbolliste nga Kosova ftohet në një kamp të tillë. Etna është

basketbolliste e grupmohave të Kosovës, ndërsa ka përfaqësuar Kosovën edhe në FIBA Europe Cup 3x3. "Është ndjenjë e veçantë të luash për Kosovën dhe ta përfaqësosh shtetin tënd në garat ndërkombëtare. Synimi im është sigurisht që në të ardhmen të luaj për Kosovën A. Sa iu përket klubeve, shpresoj se do të luaj në një ligë të fortë evropiane, pse jo edhe WNBA, pasi mendoj se me punë mund të arrij gjithçka në jetë", ka shtuar Rexhepi. Etna, po ashtu, është një nga katër basketbollistët si "Shpresë Olimpikë 2023" që jepet nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Operohet me sukses Arbër Shala

Klinë, 27 shtator - Skuadra e Dukagjinit të Klinës ka njoftuar se mbrojtësi Arbër Shala është operuar me sukses. Mbrojtësi i majtë ka pësuar një lëndim në ndeshjen e xhiros së tretë ndaj

Dritës dhe është detyruar t'i nënshtrohet një operimi. Ai do të mbetet për disa muaj jashtë fushave të blerta. "Mbrojtësi i skuadrës sonë Arbër Shala është operuar me sukses pas një lëndimi të

pësuar gjatë ndeshjes kampionale ndaj Dritës. Shala është operuar në meniskusin dhe ligamentin nga dr. Lavdim Berisha në Spitalin 'Royal Medical'. Klubi e falënderon dr. Lavdimin për

kujdesin e veçantë ndaj futbollistit tonë, njëkohësisht Arbërit i dëshirojmë shërim të shpejtë, duke shpresuar se do të kthehet në fushë sa më shpejt", thuhet në njoftimin e KF Dukagjini.



Edion Gashi i bashkohet Kosovës U19

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Një tjetër futbollist ka vendosur ta veshë fanellën e Kosovës. Bëhet fjalë për 17-vjeçarin Edion Gashi i cili luan në Bundesliga në ekipin "Schalke 04" në

grupmoshën U19. Edioni luan në pozitën e mesfushorit ofensivë dhe po kalon një formë të mirë duke treguar edhe rezultate të mira me skuadrën e tij. Punën e Edionit

nga afër e ka përcjellë përzgjedhësi i Kosovës U19, Adil Maliqi, i cili, pas një bisede me talentin kosovar në Gjermani, ka konfirmuar ardhjen e tij. Edion Gashi është

një talent që premtion shumë dhe pritet t'i tregojë aftësitë e tij edhe në grupmoshat e Kosovës. FFK-ja i ka uruar mirëseardhje dhe i ka dëshiruar shumë suksese Edionit.



Muriqi: Më duhej ky gol ndaj Barçës, tani nuk ndalem

MALLORCA, 27 SHTATOR - Fillimi i sezonit nuk ka qenë shumë i mirë për Vedat Muriqin. Ai e ka nisur me dy penallti të humbura, por në takimet e fundit të gjithë kanë nisur ta shohin Muriqin më të mirë, atë të sezonit të kaluar. Pas golit në fundjavë (me penallti), ai ka qenë protagonist absolut në barazimin 2-2 të Majorkës kundër Barcelonës të martën në mbrëmje. Sulmuesi nga Kosova ka shënuar një gol dhe ka dhënë asistim për golin e Prats, duke qenë kështu lojtari më i mirë i ndeshjes. "Ne vinim nga një humbje e shëmtuar dhe duhej t'i rregullonim gjërat, duhej të reagonim. Luanim kundër një ekipi të madh, por kur luftoni dhe luftoni, edhe fati vjen. Unë mendoj se barazimi ishte rezultati i drejtë", ka thënë Muriqi.

Mes të tjerave, Muriqi ka folur edhe për golin, duke e pranuar se është çliruar pas një ngërçi në



nisje të sezonit. "Ne e dinim se ata janë shumë të mirë me topin. Mendoj se po të kishim qenë më të kujdesshëm mund t'i kishim bërë më shumë dëme Barcelonës. Gjithsesi, një pikë ndaj tyre nuk është keq. Të mos të harrojmë se po luanim kundër kampionëve në fuqi dhe

kryesuesve të kampionatit. Edhe vetë jam i kënaqur me punën time. Unë jam një sulmues dhe kur nuk shënon, nervozohesh. Më duhej kjo ndeshje, më duhej kjo paraqitje, ky gol. Kështu është një sulmues, kur shënon një, zakonisht vijnë edhe të tjerët", ka deklaruar Muriqi.

Alonso e nxjerr makinën në ankand për mbi 2 milionë euro

MADRID, 27 SHTATOR - Fernando Alonso nuk është vetëm kampion i Formulës 1, por tashmë është edhe protagonist në tregun e ankandëve të makinave. Pas shitjes në ankandin e Ferrari Enzo's së tij, spanjulli ka vendosur të nxjerrë në shitje një tjetër xhevahir nga koleksioni personal. Bëhet fjalë për një McLaren Elva të rrallë, duke parë se ekzistojnë vetëm 149 lloje të kësaj makine, që do të dalë në ankand në prag të Çmimit të Madh të Formulës 1 të Abu Dhabi më 25 nëntor në pistën Yas Marina.

Vlera fillestare e McLaren Elva ishte 1.6 milion euro, por tani vlerësohet se mund të arrijë midis 2.3 dhe 2.8 milionë euro, nëse jo më shumë, duke marrë parasysh si kontekstin e ankandit ashtu edhe emrin e shitësit. McLaren Elva është një nga makinat më të jashtëzakonshme të ndërhuara ndonjëherë nga kompania britanike, e pajisur me



një motor 815 HP. Modeli është gjithashtu McLaren i më i lehtë për rrugë i prodhuar ndonjëherë. Ajo që e bën Elvan edhe më unike është karrociera e saj plotësisht e hapur. Kjo makinë me dy vende nuk ka xham të përparmë, prandaj duhet të mbahet një kokore për ta drejtuar atë. Për ta

kufizuar efektin e erës me shpejtësi të lartë, Elva është e pajisur me Sistemin Aktiv të Menaxhimit të Ajrit të McLaren (AAMS), i cili krijon një lloj xhami të përparmë virtual, duke e drejtuar ajrin mbi kokat e pasagjerëve për ta zvogëluar efektin e erës kundër.

SHKURT

Haller: Humbja e titullit ishte më e dhimbshme se kanceri

Borussia Dortmund e përfundoi në mënyrë dramatike sezonin e kaluar të Bundesligës teksa verdhezinjtë edhe pse e mbyllën me pikë të barabarta kampionatin me Bayern Munchen. Gjithçka varej nga vetë Dortmundi që në javën e fundit hodhi një hap fals duke barazuar 2-2 me Mainzin. Një fund i dhimbshëm, teksa Sebastian Haller guxon dhe shprehet se më shumë vuajti humbjen e titullit në javën e fundit sesa gjithë vuajtjet nga sëmundja e keqe. "E vërteta është se titulli i humbur me Dortmundin në javën e fundit të kampionatit ishte më i dhimbshëm edhe se kanceri. Kur je i sëmurë nuk ke se çfarë të bësh, duhet ta pranosh dhe të mundohesh të shohësh përpara. Por, kur e ke titullin në dorë, është shumë më ndryshe. Në atë moment duhet ta pranosh me shumë dhimbje se ke gabuar dhe se nuk ke marrë vendimet e duhura", ka thënë Haller.

Xavi: Barazimi ndaj Mallorcas nuk na mjafton

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka thënë pas barazimit ndaj Mallorcas (2-2), se ky rezultat është i pamjaftueshëm për skuadrën e tij. "Ne kishim raste të pastra, por gabuam shumë. Në fund morëm një barazim që nuk na mjafton. Ne duhet të përmirësohemi në mbrojtje", ka thënë Xavi.

Në këtë ndeshje ka shkëlqyer sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, që ka shënuar një gol dhe ka asistuar në golin tjetër.

Lëndohet Gnabry, mungon disa javë

Futbollisti i Bayern Munchenit, Serge Gnabry, do të mungojë për disa javë pas thyerjes së parakrahut të majtë në ndeshjen e Kupës së Gjermanisë kundër Munsterit, një ekip i kategorisë së tretë. "Serge do t'i nënshtrohet një operacioni dhe do të mungojë për disa javë", ka thënë trajneri Thomas Tuchel.

Gnabry u largua nga fusha në minutën e 11-të të ndeshjes pas një përplasjeje me portierin kundërshtar Johannes Schenk. Ky është një lajm i keq për Tuchelin, pasi Gnabry cilësohet një nga titullarët e tij në formacion.

Alcaraz: Duhet t'i marr vendin e parë Djokoviçit

Pas dështimit në US Open, aty ku u mposht në gjysmëfinale nga Daniil Medvedev, Carlos Alcaraz përgatitet për turneun e radhës që është ai i Beijing në Kinë. Edhe pse nuk bëhet fjalë për një turne Slam, por për një turne ATP 500, sërish spanjulli do të tentojë të fitojë për t'u rikthyer te rruga e sukseseve. Rivali i tij më i madh Djokoviç nuk do të jetë pjesë e këtij turne, teksa tenisti nga Murcia tashmë ka vendosur si objektiv rikthimin e numrit një për t'ia hequr kështu këtë status tenistit serb. "Për momentin Djokoviç është numri një, ndaj jam pjesë e këtij turne me një motivim ekstra për t'iu afruar dhe për të pasur sërish një garë për vendin e parë në botë. Unë mendoj për këtë sa herë stërvitem dhe sa herë marr pjesë në një turne. Nuk është diçka që duhet ta arrij patjetër, por më duhet t'i vendos vetes gjithnjë objektiva. Për mua numri një në botë është një nga objektivat kryesor ndaj jam në ndjekje të këtij synimi. Do të mundohem të bëj sa më mirë, të jem pranë vendit të parë dhe më pas ta rifitoj sërish atë", u shpreh Alcaraz.

Amrabort: Për Unitedin luaj edhe portier

Sofyan Amrabort u transferua këtë merkato nga Fiorentina te Manchester Unitedi me anë të formulës së huazimit. Të martën mesfushori zbriti për herë të parë në "Old Trafford" me fanellën e "Djajve të Kuq",

pasi më parë ishte aktivizuar vetëm dy minuta në transfertë ndaj Burnleyt. Marokeni ishte një ndër më të dalluarit për Unitedin në triumfin 3-0 përballë Crystal Palaces në EFL Cup, ndërsa pas sfidës

theksoi se kishte punuar të gjithë jetën për ta shijuar atmosferën e një stadiumi si "Old Trafford". "Mendoj se ishte mbrëmja e përkryer. Luajtëm shumë mirë dhe mbi të gjitha fituam me shifrat 3-0.

Isha në fushë për rreth një orë. Kam ëndërruar për një mbrëmje të tillë prej fëmijërisë sime. Kam punuar shumë fort gjatë gjithë karrierës. Të luash në 'Old Trafford' është e mrekullueshme. Ishte e martë

dhe stadiumi ishte sërish plot, ndjesi fantastike. Ia bëra të qartë edhe Ten Hag se jam i gatshëm të luaj në çdo pozicion në fushë. Edhe portier nëse është nevoja", u shpreh Amrabort.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Toni Compani” Shpk, Sojevë, Ferizajnë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë “Toni Compani” Shpk, Sojevë, Ferizaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.11.2023 në ora 11:00 në Objekti “Kulla e Lirisë” Reçak, Shtime, do të organizohet debat publik nga Kompania “Toni Compani” Shpk, Sojevë, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për eksploatin e gëlqeroreve në Reçak, K. Shtime.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Zoom:

Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/2290262270?pwd=wh1a3KMLfTOxYqOuerxDSxSKB CJ7Ss.1#success>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së

për Kompaninë “Toni Compani” Shpk, Sojevë, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për eksploatin e gëlqeroreve në Reçak, K. Shtime.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Lumë's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Leart Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu “Bajram Curri”, Krushe e Madhe.

- Edi Xhezairi shpall të pavlefshme diplomën , dëftesat, certifikatën shne “Ymer Prizreni” Prizren.

- Kemajl Beka shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Arkitekt Sinani” ish shkolla “Boris Kidric”.

- Sara Ibishi shpall te pavlefshme dëftesat diplomën e shkollës së mesme të lartë “Xheladin Deda”.

- Muhamet Kurta shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Arkitekt Sinani” ish shkolla “Boris Kidric”.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma,

kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

